



INSTITUTI I HISTORISË
“ALI HADRI” PRISHTINË



INSTITUTI
I HISTORISË
- Tiranë -
INSTITUTI I HISTORISË
TIRANË



1953
INSTITUTI
ALBANOLOGJIK
PRISHTINË



INSTITUTI PËR
TRASHËGIMINË
KULTURORE TË
SHQIPTARËVE - SHKUP

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI”-PRISHTINË INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI”-PRISHTINA

Instituti i Historisë “*Ali Hadri*” në Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Tiranë, Institutin Albanologjik në Prishtinë, dhe me Institutin për Trashëgiminë Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, organizojnë Konferencën shkencore: “*Gjenocidi kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX*”. Kumtesat do të mbahen nga studiues, të cilët do të shtjellojnë gjerësisht pikëpamjet dhe kërkimet e tyre shkencore në kuadër të tematikave të përgjithshme të përcaktuara nga Këshilli Organizues.

Konferenca do të mbahet me datë 8 prill 2022 në Prishtinë, dhe do t’i japë mundësinë studiuesve të kontribuojnë me kumtesat e tyre. Kumtesat e Konferencës, do të botohen në kuadrin e përmbledhjeve të punimeve të Konferencës, të cilat do të përgatiten për botim më së largu deri në qershor të vitit 2023.

Këshilli Organizativ ka parapa këto teza të përgjithshme:

1. Aktet juridike ndërkombëtare mbi gjenocidin
2. Projektet dhe elaboratet serbe kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX dhe XX
3. Dhuna, terrori dhe shpërngulja e dhunshme e shqiptarëve nga territoret verilindore të vilajetit të Kosovës, 1804-1878
4. Presioni serb për asimilimin e shqiptarëve ortodoksë në Kosovë (1878-1912)
5. Dhuna dhe terrori ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe vise tjera shqiptare gjatë luftërave ballkanike (1912-1913) dhe Luftës së Parë Botërore, 1914-1918
6. Shpërnguljet e shqiptarëve, Reforma Agrare dhe kolonizimi, 1918-1941
7. Krimet, masakrat, burgosjet dhe pushkatimet kundër shqiptarëve nga komunistët jugosllavë dhe bullgarë, gjatë dhe në përfundim të Luftës së Dytë Botërore
8. Proceset gjyqësore kundër shqiptarëve nga shpallja e Rezolutës së Informbyrosë (korrik 1948) deri në rënien e komunizmit dhe shpërnguljet për në Turqi
9. Dhuna, terrori dhe burgosjet kundër shqiptarëve, gjatë viteve 1990-1997
10. Vrasjet dhe masakrat gjatë luftës së vitit 1998/1999 në Kosovë dhe vise tjera shqiptare
11. Shkatërrimi i institucioneve kulturore, shëndetësore, ekonomike, sociale, shkencore dhe arsimore të Kosovës
12. Politika kishtarë serbe kundrejt shqiptarëve në Kosovë

13. Qëndrimi i politikës së sotme serbe ndaj fenomenit të gjenocidit dhe tiparet e saj në raport me këtë çështje
14. Qëndrimi i Fuqive të Mëdha dhe i organizmave ndërkombëtar ndaj akteve të gjenocidit kundrejt shqiptarëve.

Studiuesit, abstraktet mund t'i dërgojnë deri më datën 20 shkurt 2022, në adresën elektronike të Institutit të Historisë-Prishtinë: institutihis@hotmail.com